



Raporti i vëzhgimit afatshkurtër të zgjedhjeve vendore, 21 qershor 2015

Observatori për të Drejtat e Fëmijëve në bashkëpunim me Qendrën Ballkanike për Bashkëpunim dhe Zhvillim BCCD u akredituan nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) si vëzhgues afatshkurtër në zgjedhjet vendore të 21 qershor 2015. Për realizimin e këtij raporti vëzhgimi, falenderojmë të gjithë vëzhguesit e 2 organizatave, të cilët u angazhuan përgjatë ditës së zgjedhjeve në 9 rrethet e vendit, stafin bashkëpunues në ditën e zgjedhjeve (komisionerë, përfaqësues të Qendrave të Votimit) të cilët u treguan të gatshëm për të ndarë gjetjet dhe raportimet e tyre me stafin tonë. Një falenderim i veçantë shkon për KQZ, që na dha mundësinë e përfshirjes sonë si vëzhgues afatshkurtër në zgjedhjet vendore.

Observatori dhe BCCD kanë shpërndarë 18 vëzhgues të lëvizshëm e të paanshëm në 9 rrethe të ndryshme, duke monitoruar secili nga 3 qendra votimi. Vëzhgimi afatshkurtër në ditën e zgjedhjeve të 21 qershorit, u realizua në 27 qendra votimi në orarin 10:00- 12:00.

Përgjatë vëzhgimit, u monitoruan 3 qendra votimi për secilin qark, në total 27 qendra. Konkretisht:

- Berat (32/67, 32/68, 32/68/1)
- Dibër (1145, 1146, 1146/1)
- Elbasan (2306, 2345/1, 2365/1)
- Gjirokastër (4252, 4253, 4238/1)
- Korçë (36/35, 36/46, 36/47)
- Lezhë (714, 714/2, 740)
- Shkodër (276, 305, 311/1)
- Tiranë (1784, 1784/1, 1762/2)
- Vlorë (4508/1, 4429, 967)

Sipas të dhënave të vëzhguesve, 100 % e Qendrave të vëzhguara u hapën në përputhje me kodin zgjedhor edhe orarin e përcaktuar nga KQZ. Proçesi i votimit nga hapja e tij e deri në momentin e vëzhgimit, ka vazhduar i qetë dhe pa ndërprerje. Dita e zgjedhjeve, përgjatë orarit të vëzhgimit, ishte relativisht e qetë krahasuar me periudhën e fushatës, me pak incidente dhune të raportuara. Këto qendra votimi kanë qenë të pajisura me të gjithë infrastrukturën zgjedhore të nevojshme në përputhje me kriteret ligjore duke mos krijuar vështirësi proçeduriale (2 Kutit votimi, lista e votuesve tek anëtarët e komisionit dhe e afishuar në hyrje të qendrës së votimit, vula, 5 komisioner, etj). Proçedurat e votimit u respektuan gjerësisht në këto Qendra Votimi të vëzhguara.


Të drejtat e vëzhguesve u respektuan gjerësisht dhe në 100 % të rasteve, vëzhguesit e Observatorit dhe BCCD arritën të vëzhgojnë proçesin zgjedhor pa u penguar. Vëzhguesit nuk vërejtën ndonjë shkelje të rëndë përgjatë orarit të vëzhgimit, e cila do mund të ndikonte tek rezultatet e zgjedhjeve. Një rast i veçantë është shënuar në një nga qendrat e votimit në Tiranë, në të cilën një votues i pajisur me mjetin e

identifikimit të djalit (kartë identiteti) kërkonte të votonte në emër të tij. Anëtarët e komisionit nuk e lejuan që të ndodhte një dukuri e tillë.

Deri në momentin e përfundimit të vëzhgimit (ora 12:00), përqindja e votuesve në secilën prej qendrave të vëzhguara nuk tejkalonte shifrën e 14 % të listës së votuesve. Përqindja më e lartë është evidentuar në qendrat e votimit të Lezhës me 14 % të votuesve që e kanë shprehur vullnetin e tyre. Qendrat e votimit me një përqindje më të ulët janë evidentuar në Elbasan me 7%.




Përgjatë orarit të vëzhgimit të 27 qendrave të votimit, është evidentuar një përqindje më e lartë e pjesëmarrjes së meshkujve në votim 56 % në raport me nivelin e pjesëmarrjes së femrave 44 %.



Votuesit e rinj që shprehin vullnetin e tyre për herë të parë në këto zgjedhje vendore, përbëjnë një kategori të rëndësishme, që është bërë objekt i monitorimit dhe vëzhgimit nga Observatori për të Drejtat e Fëmijëve dhe Qendra Ballkanike për Bashkëpunim dhe Zhvillim.


Përqindja e votuesve sipas gjinisë dhe votuesit për herë të parë (të rinjtë)

■ Femra ■ Meshkuj ■ Të rinj



Nga raportimet e realizuara nga 18 vëzhguesit, është evidentuar një përqindje e ulët e njerëzve që kanë votuar deri në momentin e mesditës. Për rrjedhojë në qendrat e votimit është evidentuar një numër i vogël i individëve që presin në rradhë për të votuar. Në 74% të qendrave të vëzhguara, janë më pak se 10 persona në rradhë që presin të votojnë dhe në 26% numri varion nga 10- 30 persona. Në asnjërën prej qendrave të votimit nuk rezultojnë mbi 30 persona që presin në rradhë për të votuar. Kjo justifikon një nivel të ulët të pjesëmarrjes së qytetarëve në votim.

Përqindja e qendrave të votimit sipas rradhës së njerëzve për të votuar



Në qendrat e vëzhguara, votimi është kryer në formë të pavarur nga secili individ. Megjithatë në disa prej qendrave të votimit është evidentuar një votim kolektiv dhe familjar i votuesve. Brenda qendrave të votimit nuk kishte materiale promocionale (poster, flamur, bluza, etj) të kandidatëve për kryetar Bashkie.

Në 1 nga 27 qendrat e votimit të vëzhguara (në Tiranë), ka patur prani të medias, si raportuese e ngjarjeve më të fundit dhe ecurisë së procesit të votimit. Në zonat afër qendrave të votimit, ka patur patrulla policie për kontrollimin e rendit dhe sigurisë së votuesve.

Fatkeqësisht, të gjitha qendrat e votimit, u vlerësuan nga vëzhguesit si të paaksesueshme nga votuesit me aftësi të kufizuar. Përgjatë momentit të vëzhgimit, në qendrën e votimit nr 1146/1 në Dibër, një votues tetraplegjikë u ndihmua nga të afërmit, të cilët e ngritën së bashku me karrocën në katin e tretë të shkollës në të cilën kryhej votimi.

KQZ ka akredituar disa vëzhgues afatshkurtër për të patur akses në të gjitha qendrat e votimit në orarin e vëzhgimit në ditën e zgjedhjeve. Në 33 % të qendrave të vëzhguara (9 nga 27 qendrat e votimit), ka patur një prani të vëzhguesve të tjerë të pavarur ndërkombëtar (OSBE, KSHH- Komitetit Shqiptar të Helsinkut) dhe kombëtar (si Koalicioni për Zgjedhje të Lira dhe të Ndershme), për mbarëvajtjen e procesit të votimit në qendrat përkatëse.

Një aspekt shqetësues është evidentuar në rradhët e vëzhguesve të forcave të ndryshme politike, të cilët autorizimet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nuk i kishin vendosur në vende të dukshme, sipas udhëzimit përkatës. Vëzhguesit e pavarur e kanë patur të vështirë të identifikonin se cili prej personave ishte qytetarë i thjeshtë dhe cili prej tyre ishte i akredituar si vëzhgues i forcave politike.

Një ndër aspektet më shqetësuese të votimit, është presioni mbi votën, si një cënim i të drejtës së çdo personi për të zgjedhur në gjendje të lirë. Në 18% të qendrave të votimit (5 nga 27 qendra votimi) janë vëzhguar grupime individësh, të cilët kanë qendruar për një kohë të gjatë përpara hyrjes së qendrës së votimit.

Në momentin e vëzhgimit, në disa qendra votimi (Tiranë 1784, 1784/1) po kryhej një Exit poll, financuar nga televizion lokal dhe kompani e sondazheve të zgjedhjeve.

Përgjatë periudhës së vëzhgimit, nuk u raportua ndonjë incident në lidhje me pretendime të ndryshme të qytetarëve si: mosgjetja e emrit në listë, mospërputhje e emrit në listë etj. Vlen të theksohet se përgjatë realizimit të vëzhgimit, në tërësi ka patur një mbarëvajtje të procesit të votimit.